


Diaspora shqiptare / Këshilli i Ministrave marrëveshje me qeverinë e Malit të Zi



Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka firmosur një marrëveshje me homologët e Malit të Zi për bashkëpunime në fushën e Diasporës Shqiptare. Kjo marrëveshje ka në thelb krijimin e një baze ligjore me qëllim sigurimin e një bashkëpunimi në fushën e Diasporës, afatgjatë me interes reciprok, çka në të ardhmen do të shërbejë për të zhvilluar dhe forcuar me tej marrëveshjet dypalëshe ekzistuese mes dy vendeve në fushën e Diasporës. Sipas marrëveshjes të dy vendet do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe programeve në fushën e Diasporës, do të inkurajojnë bashkëpunimin direkt ndërmjet institucioneve përgjegjëse të Diasporës, i cili do të realizohet përmes shkëmbimit të vizitave të drejtuesve dhe ekspertëve në fushat përkatëse si dhe përmes konferencave apo aktiviteteve të përbashkëta. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje vjen si domosdoshmëri për të ngritur infrastrukturën institucionale, të nevojshme për zhvillimin e lidhjeve me Diasporën, veçanërisht për ndërmarrjen e masave në nivel ekzekutiv për realizimin e të drejtave politiko-ekonomike të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve.


Vota e Diasporës Shqiptare



Të interesuarit për të drejtën e votes në migracion, mund të gjejnë propozimet që i janë dërguar Komisionit të Reformës Zgjedhore [këtu](#).

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës takim online me drejtuesit e institucioneve të Diasporës

Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD) zhvilluan një takim online me drejtuesit e institucioneve të Diasporës, për tu njohur nga afër me arritjet, sfidat dhe projektet për të ardhmen. Në takim morën pjesë znj. Sonila Hysi, Drejtoreshë Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Majlinda Vogli, Drejtoreshë Ekzekutive e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, znj. Mimoza Hysa, Drejtoreshë e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Diana Kastrati, Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe znj. Ada Ilia, Drejtore e Kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Diasporën. Diskutimi u hap nga znj. Sonila Hysi, e cila drejtoi këtë takim. Mbledhja vijoi me prezantim e rezultateve, sfidave dhe projekteve të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës nga znj. Majlinda Vogli. Znj. Mimoza Hysa bëri një prezantim të ecurisë së projekteve të Qendrës së Botimeve për Diasporën, problematikat dhe zgjidhjet. Prezantimin e mbylli znj. Diana Kastrati, e cila informoi lidhur me misionin dhe objektivat e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, platformën e punës për vitin 2020, si dhe vizionin për vitin 2021. Mbledhja vijoi me diskutimet e anëtarëve të KKD-së mbi mundësinë e kontributit të kësaj strukture në mbështetjen dhe përmirësimin e veprimtarive të institucioneve të Diasporës.



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës"



"Rrjeti i Profesionistëve të Diasporës" është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetimin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionale të ndryshme në diasporë.

Ministri Majko me Fondacionin Besa / Bashkëpunime me sipërmarrësit nga Diaspora



Ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko ka zhvilluar një takim me përfaqësues të Fondacionit Besa: z. Anton Krasniqi, kryetar, WEGO distributor i materialeve ndërtimore, z. Ilir Seferi nënkryetar, ekonomist i turizmit dhe hotelienisë z. Rexhep Nikci, sektori i arsimit dhe kulturës, z.Misim Berisha, sekretar dhe këshilltar si dhe z. Xhevdet Mulaj, avokat ndërkombëtar. Takimi u fokusua në mundësinë e bashkëpunimit midis Fondacionit Besa dhe institucioneve të Diasporës, me qëllim kontribimin në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit. Gjatë takimit, ministri Majko u prezantoi pjesëmarrësit institucionet e Diasporës, projektet në zbatim si dhe mekanizmat e tjera të krijuara, si: Këshilli Koordinues i Diasporës, Dhoma e Biznesit të Diasporës etj., me qëllim krijimin e hapësirave për nisjen e bashkëpunimit. Një bashkëpunim, i cili për vetë natyrën e fondit "Besa" mund të jetë më frytdhënës në partneritet me Dhomën e Biznesit të Diasporës. Kjo, pasi Dhoma e Biznesit të Diasporës është duke bashkëpunuar me dy agjencitë "AIDA" dhe "Adisa" për të ofruar një shërbim të plotësuar nga ana institucionale. Fondacioni "Besa", është një shoqatë e biznesit shqiptar në Mynih e themeluar me qëllim të një bashkëpunimi me ndërmarrjet shqiptare në Republikën e Bavarisë dhe krijimin e një rrjeti biznesesh shqiptare.

Platforma Digjitale e Veprave Shqiptare



Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen.

QBD-ja, pjesë e takimit virtual "Edukimi dhe Menaxhimi i Sistemit Arsimor gjatë COVID-19 dhe Kontributi i Diasporës nga Gjermania"



"Edukimi dhe Menaxhimi i Sistemit Arsimor gjatë COVID-19 dhe Kontributi i Diasporës nga Gjermania" ishte tema e takimit virtual me profesionistë të edukimit në Kosovë, Shqipëri dhe Gjermani, organizuar nga "GERMIN". Drejtoreja e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa, ishte pjesë e këtij diskutimi për mësimdhënien, e ftuar në cilësinë e panelistes për të trajtuar mundësitë e sfidat e bashkëpunimit dhe angazhimit profesional në vendet e origjinës, duke pasur parasysh dëmet të shkaktuara nga COVID-19. "Jam e nderuar që jam në këtë bashkëbisedim, në këtë kuvend të gjerë, me pjesëmarrës nga të gjitha vendet. E nderuar, se flasim të gjithë të njëjtën gjuhë, pavarësisht nga origjina jonë...", u shpreh znj. Hysa, e cila duke falënderuar "Germin" për punën e bërë kushtuar Diasporës, bëri një prezantim të shkurtër të QBD-së, duke e vënë theksin që përkushtimi kryesor i këtij institucioni ka qenë më së pari plotësimi i nevojave të shkollave shqipe jashtë trojeve shqiptare me tekste shkollore, materiale të tjera shtesë didaktike etj. Qendra ka vijuar punën e saj njëkohësisht duke pasur në fokus një element shumë të rëndësishëm të mësimdhënies në Diasporë që është dygjuhësia, në kuadër të së cilës ajo ka hartuar e botuar fjalorët dygjuhësh, ka filluar botimin e serisë "Klasikët dygjuhësh", botimin dygjuhësh "Tregime të moçme shqiptare" në pesë gjuhë të huaja etj.

Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Botimi dygjuhësh shqip-italisht "E bukura dhe bisha"/ "Ujku dhe shtatë kecat", falas nga QBD



Ndër mijëra tekste mësimore të dërguara rishtas në të gjitha shkollat e gjuhës e kulturës shqiptare në Diasporë për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021 janë dhe botimet dygjuhëshe të Qendrës së Botimeve për Diasporën. "E bukura dhe bisha" dhe "Ujku dhe shtatë kecat", dy nga përrallat më të dashura për fëmijët, pjesë e serisë "Klasikët Dygjuhësh" – projekt i Qendrës së Botimeve për Diasporën, flasin shqip dhe italisht. "E bukura dhe Bisha", përralla që sipas studiuesve daton 4000 vjet më parë, u bë e njohur botërisht falë versionit të autores franceze Jeanne-Marie Leprince de Beaumont (1711-1780). Më së pari u botua më 1740 në "La Jeune Américaine et les contes marins" (Amerikani i ri dhe përrallat detare) dhe në një version të përmirësuar nga autorja franceze më 1756 "Magasin des enfants" (Revista e fëmijëve). Libri i sjellë në shqip nga Panid Teferiçi dhe në italisht nga Griselda Doka, i pajisur me ilustrime shumë të këndshme, ka një tekst të thjeshtë dhe me fjalët më të përdorshme në dy gjuhë që lehtësojnë mësimin e gjuhës në mënyrë argëtuese. "E bukura dhe bisha" dhe "Ujku dhe shtatë kecat", shqip dhe italisht vjen falas për fëmijët shqiptarë të Diasporës dhe falas në versionin online për të gjithë.

"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#); Play store [këtu](#).

Zhvillohet takimi online me Oficerët Koordinues për Çështjet e Diasporës

Agjencia Kombëtare e Diasporës zhvilloi një takim virtual me Oficerët Koordinues për Çështjet e Diasporës në kuadër të Vendimit Nr. 780, datë 06.11.2019 "Për caktimin e Oficerëve Koordinues për Çështjet e Diasporës Shqiptare në Konsullatat Shqiptare në Itali dhe Greqi" i Këshillit të Ministrave. Në këtë takim morën pjesë, znj. Sonila Hysi, Drejtore e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, z. Armand Skapi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Ada Ilia, Drejtore e Kabinetit të Ministrisë të Shtetit për Diasporën, znj. Aurela Konduri, Oficer Koordinues në Selanik, znj. Joneda Dodaj, Oficer Koordinues në Athinë, znj. Luljeta Cobanaj, Oficer Koordinues në Milano dhe z. Edmond Kumaraku, Oficer Koordinues në Romë. Diskutimet u përqëndruan mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Oficerëve Koordinues për Çështjet e Diasporës në zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetet shqiptare në shtetin pritës, identifikimin e nevojave për arsimimin dhe komunikimin me mësuesit e programeve plotësuese të gjuhës e të kulturës shqiptare, nxitjen dhe organizimin e bizneseve shqiptare në vendin pritës, si dhe identifikimin dhe asistimin e shtetasve shqiptarë, të cilët vuajnë dënimin me heqje të lirisë në shtetin pritës.

